



DPK/DMP
01

03-178/2013
28-01-2013



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U
PRIŠTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr.regj. 32187/2012

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën kundërvajtës kundër të pandehurës Hanife Vllasaliu nga Novoberda për kundërvajtje nga neni 8 paragrafi 1 e sanksionuar sipas dispozitës ndëshkimore neni 17 par 1 pika 1.1 të Ligjit nr. 04/L-050 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave për të gjithë personat zyrtar, e në bazë të nenit 73,74,195, 199, të LMK me dt. 31.12.2012 merr këtë:

A K T V E N D I M

E PANDEHURA : Hanife Rexhep Vllasaliu, e lindur më 1949 në Prishtinë, tanimë vendbanim në Novoberd, me profesion anëtare e kuvendit K. Novoberd, e martuar, shkollën e mesme të kryer, gjendjes së dobët ekonomike.

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

E pandehura në cilësinë e anëtares në Kuvendin Komunal në Novoberd, nuk e ka deklaruar gjendjen e pasurisë, i cili bëhet me deklarimin e rregullt vjetor deri me datën 31.03.2012 të çdo viti kalendarik në Agjencionit Kundër Korrupsionit Me këtë ka kryer veprën kundërvajtës nga neni 8 paragrafi 1 e sanksionuar sipas dispozitës ndëshkimore neni 17 par 1 pika 1.1 të Ligjit nr. 04/L-050 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave për të gjithë personat zyrtar, andaj për këtë:

Q O R T I M

Shpenzime të procedurës nuk ka patur,

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit, parashtrori kërkesën nr.01 2527/2012 të dt 30.07.2012 për fillimin e procedurës kundërvajtës kundër të pandehurit së përmendur më lartë dhe për kundërvajtjen e lartcekur, ku dhe është marrë konkluzioni për fillimin e procedurës kundërvajtës.

Gjatë procedurës u dëgjua e pandehura e cila në deklaratën e saj, deklaroi se sa i përket se mos përmbushjes së formularit për mos deklarimin e pasurisë, ku unë e kam pranë me kohë nga kryesuesi i Kuvendit, ku data nuk me kujtohet por gjatë kësaj kohe vajzën tim Shukrie Mustafa jeton në përkohësisht në Zvicër e ka pas gjendjen të rënd shëndetësor, ku dhe për dëshmojnë dokumentacion mjekësor, ku mund të japë dëshmojë dhe për shkak të kësaj gjendje të vajzës sime kam qenë në depresion të madhe, dhe me ka dal nga mendja që ta mbushi këtë formular, për këtë shkak nuk e kam mbushur se unë nuk kam ndonjë rrethanë që mos ta mbushi këtë formular ngase unë pranoj nga 200 eu. nga Kuvendi Komunal, si dhe burri i merr 80 eu. pension, ku të gjitha na shkojnë për barna. dhe nuk e kam pas për qellim që të shmangem mos deklarimit të kësaj pasurie ku dhe e kam deklaruar pasurinë, dhe në fund da ta njoftoj gjyqtarin se me rastin që çdo lloj dënimit që me shqiptohet mua me rrezikohen kushtet me ekzistenciale për jetë, çfarëdo lloj dënimi që me shqiptohet me gjobë unë nuk mund ta paguar por me duet ta vuaj me burg.

Andaj gjyqtari pas administrimit të provave dhe të provuarit të kësaj çështje me të drejtë dhe në mënyrë të plotë vërtetoi gjendjen faktike se pandehuri ka kryer kundërvajtje, i cili u shpall përgjegjës dhe ju shqiptoi Masa QORTIM pasi që u konstatua se ekzistojnë rrethanat, të cilat në masë të konsideruar e zvogëlojnë përgjegjësinë e kryesuesit të kundërvajtjes, pasi që e njëjta gjatë kësaj kohe kishte të smaur vajzën dhe ishte në një gjendje të rënd psikike- depresion, dhe po ashtu pas kësaj gjendje shpirtërore të cilin e ka pas e ka mbush formularin për deklarimin e pasurisë, e cila do të thotë se nuk ka pas qellim që të shmanget këtij obligimi andaj mund të pritët që edhe pa dënimin e dënimit, i njëjti në të ardhmen do të shmanget nga kryerja e veprave të këtuilla dhe të ngjashme, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

GJYQTARI PËR KUNDËRVAJTJE

Patmir Behrami

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala dhe ushtruesi i kërkesës ankesë mund të ushtrohet Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh, prej ditës së marrjes së këtij aktvendimi nëpërmjet të kësaj Gjykate dhe pa taksa.